



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 242/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Ferki Xhaferi dhe Adnan Konushevci anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Valbona Millaku Foniqi, duke vendosur lidhur me ankesat e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA me seli në Prishtinë, të paraqitura ndaj koalicionit Nisma- AKR- PD, me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 06.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohen të pabazuara ankesat: Anr.242/2019, Anr. 243/2019, Anr.267/2019, Anr.271/2019, dhe Anr.276/2019, të gjitha të datës 05.10.2019, të paraqitura nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, me seli në Prishtinë, kundër koalicionit NISMA-AKR-PD, me seli në Prishtinë, për shkak të vazhdimit të sponsorimit të fushatës zgjedhore në rrjetin social “Facebook”, edhe në ditën e heshtjes zgjedhore.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar ankesat: Anr.242/2019, Anr. 243/2019, Anr.267/2019, Anr.271/2019, dhe Anr.276/2019, të gjitha të datës 05.10.2019, të paraqitura nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, të paraqitura kundër koalicionit Nisma-AKR-PD, me të cilat kanë pretenduar, se me datë 05.10.2019, gjatë ditës së heshtjes zgjedhore, kandidatët për deputet të paraqitur në ankesat e lartcekura, kanë vazhduar sponsorimin e fushatës zgjedhore në “Facebook”, edhe në ditën e heshtjes zgjedhore. Më këtë rast pretendohet se është bërë thyerje e heshtjes zgjedhore, të përcaktuar me LZP. Me propozim për PZAP-in, që ankesat të pranohen si të bazuar.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së ankesave dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, provave materiale - fotografive të bashkangjitur, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesat janë të pabazuara, për këto arsye:

Paneli paraprakisht ka vlerësuar se ankesat: Anr.242/2019, Anr. 243/2019, Anr.267/2019, Anr.271/2019, dhe Anr.276/2019, të gjitha të datës 05.10.2019, janë për nga përmbajtja të njëjta, për nga natyra e shkeljes së pretenduar janë të njëjta, janë paraqitur kundër subjektit të njëjtë politik, prandaj paneli bazuar në nenin 8 paragrafi 3 i Rregullave dhe Procedurave Nr.02/2015, të PZAP-it, në të cilën përcaktohet se: *Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të*

ankesave kryesuesi i panelit vend marres mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato ankesa të trajtohen me një vendim”, andaj paneli bëri bashkimin e ankesave dhe për të njëjtat vendosi me një vendim, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli vlerëson se parashtruesit e ankesave në mbështetje të pretendimeve për ankesat, nuk kane ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, për të provuar se shkelësit e supozuar e kanë vazhduar sponsorimin e fushatës zgjedhore edhe në ditën e heshtjes zgjedhore me datë 05.10.2019.

Nga provat e ofruar nga ankuesi, nuk mund të vërtetohet në mënyrë bindëse dhe të qartë se reklamata e shkelësve të supozuar janë publikuar apo kanë vazhduar sponsorimet e fushatës zgjedhore edhe në ditën e heshtjes zgjedhore, sepse me asnjë provë shkresore nuk është argumentuar, data dhe ora e reklamave të shkelësve të supozuar që pretendohet, se janë publikuar apo kanë vazhduar sponsorimet e fushatës zgjedhore edhe në ditën e heshtjes zgjedhore.

Ditën e shqyrtimit të këtyre ankesave, paneli ka hetuar nëse sponsorizimet e supozuara janë aktive por që nuk ka qenë e mundur të vërtetohet në rrugë elektronike nëse të njëjtat një ditë më parë kanë qenë aktive dhe në kohën e testimit të njëjtat kane qene jo aktive.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.242/2019 më datën 06.10.2019

Kryesuesi i Panelit

Faton Ademi

Faton



Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, në kuptim të nenit 118 paragrafi 4 i LZP-së.*